



Republika e Kosoves
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Dragash
Opština Dragas
Municipality Dragas

Në bazë të nenit 12 alineja 12.2, pika d dhe nenit 14 alineja 1 e të Ligjit 03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dt.15.06.2008), , nenit 10, alineja 1.5 e Ligjit mbi Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtëshme të Komunës (Ligji Nr.04/L-144- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.35 e dt.17.12.2012), neni 20 alineja 11 e Rregullores të QRK nr.23/2013 për caktimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtëshme të Komunës, si dhe nenit 32.2 të Statutit të Komunës së Dragashit 01 Nr.06-103/1 të dt.11.09.2008, e sipas Kërkesës së NPN „Renelual Tahiri“ Sh.p.k.Prizren 01 Nr.463-20042 të dt.19.10.2016, Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e dt.14.12.2016, miraton këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTËSHME
NPN „RENELUAL TAHIRI“ Sh.p.k.Prizren

- I. MIRATOHET** Vendimi për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtëshme komunale NPN „Renelual Tahiri“ - Shpk Prizren, për realizimin e investimeve në sektorin e energjisë, pa procedurë të konkurimit.
- II.** Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, jepet në shfrytëzim këto prona të paluajtëshme:
- Në tërësi parcela kadastrale P-70604030-00011-0, troll bujqësor (livadh i kl.IV-të), me sipërfaqe prej 1585 m/2, ZK Orçusha,
 - Pjesa e parcelës kadastrale P-70604038-01128-0, troll ndërtimor (shtëpi-ndërtesë) në sipërfaqe prej 26 m/2, ZK Shajne,
 - Pjesa e parcelës kadastrale P-70604032-01183-0, troll bujqësor (kullotë e kl.III-të) me sipërfaqe prej 623 m/2, ZK Pllava II, dhe
 - Pjesa e parcelës kadastrale P-70604032-01125-0, troll bujqësor (kullotë e kl.IV-të) me sipërfaqe prej 29 m/2, ZK Pllava
- III.** Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtëshme të Komunës së Dragashit, e përmendur në pikën II të këtij Vendimi është realizimi i investimeve në sektorin e energjisë (prodhimi i energjisë elektrike nga energjia e ripërtitshme)
- IV.** Prona e paluajtëshme e Komunës, e përmendur në pikën II të këtij Vendimi, jepet për shfrytëzim prej 20 viteve, përkatësisht deri në vlefshemerinë e Lejes Ujore.
- V.** Prona e paluajtëshme e përmendur në pikën II të këtij Vendimi jepet në shfrytëzim, me kompenzim. Shuma vjetore do të paguhet nga NPN „Renelual Tahiri“ Shp.k. Prizren në shumë prej 930,12 euro.
- VI.** Të drejtat dhe obligimet palët do t'i rregullojnë me Kontratë të posaçme në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit kompetent të shfrytëzimit të pronës.
- VII.** Për zbatimin e këtij Vendimi përkujdesen Kryetari i Komunës-Dragash dhe organi kompetent për regjistrimin e pronës së Komunës-Dragash.
- VIII.** Vendimi hynë në fuqi 15 ditë nga regjistrimi në protokolin e MAPL-së, si dhe publikimit në gjuhët Zyrtare, në web-faqen e Komunës-Dragash.

01 Nr.06-22263/2
Dt.14.12.2016
D r a g a s h

KUVENDI KOMUNAL-DRAGASH



Kryesuesi

Shaban Shabani